

BLESSED INVESTMENT sh.p.k
Pasqyrat Financiare Individuale më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITIUESIT TE PAVARUR	i-iii
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA INDIVIDUALE E PERFORMANCËS	2
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSIT TË MJETAVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE INDIVIDUALE	5-22



RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi Gjenerall
Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakun dhe drejtimin e Shoqërisë Blessed Investment sh.p.k.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare individuale

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të shoqërisë Blessed Investment sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, si dhe pasqyrën individuale të performancës, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjeter

Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare individuale në 30 qershor 2022.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i llogjikon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshe e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Bujar Bendo

Auditues i Gjor
RSM Albania

Tiranë, 30 qershor 2023



Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2022

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	22,892,831	83,631,824
Huadhënie ndaj palëve të lidhura	5	969,613,390	162,376,748
Aktive te prodhuara per shitje	6	253,364,662	439,023,212
Të arkëtueshme ndaj paleve te lidhura	7	270,178,320	131,780,638
Të tjera të arkëtueshme	8	169,679,656	166,559,360
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,685,728,859	983,371,782
Aktivitet afatgjata			
Huadhënie afatgjatë ndaj palëve të lidhura	5	24,673,680	26,084,160
Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje	9	144,706,798	144,845,234
Aktive afatgjata materiale	10	193,583,605	194,911,699
Aktive afatgjata per investim	11	404,410,780	268,269,992
Totali i aktiveve afatshkurtra		767,374,863	634,111,085
Totali i aktiveve		2,453,103,722	1,617,482,867
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	4,281,136	139,784
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	324,339,760	337,478,915
Detyrime tatimore	14	10,128,241	19,813,645
Parapagime te marra	15	90,555,049	198,066,316
Të tjera detyrime	16	1,758,778	1,758,778
Totali i detyrimeve afatshkurtra		431,062,964	557,257,438
Detyrime afatgjata			
Hua te marra nga bankat	17	571,150,000	-
Totali i detyrimeve afatgjata		571,150,000	-
Totali i detyrimeve		1,002,212,964	557,257,438
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	18	7,000,100	7,000,100
Fitime të mbartura		1,053,225,330	926,001,123
Fitimi i ushtrimit		390,665,328	127,224,206
Totali i kapitalit		1,450,890,758	1,060,225,429
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,453,103,722	1,617,482,867

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë aprovuar nga administratori i BLESSED INVESTMENT sh.p.k më 26.06. 2023 dhe janë firmosur si më poshtë.

Ana Lleshi

Ana Lleshi
Administratore

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

BLESSED INVESTMENT SHPK
NIPT: L71423028S
1

Pasqyra Individuale e Performancës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhurat	19	570,458,540	999,330,618
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		551,525,496	992,886,618
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		18,933,044	6,444,000
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(354,535,315)	(838,679,912)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme	20	(336,550,063)	(834,467,816)
Të tjera shpenzime	21	(17,985,252)	(4,212,096)
Shpenzime të personelit	22	(8,596,294)	(3,487,234)
Paga dhe shpërblime		(7,709,333)	(3,047,549)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(886,961)	(439,685)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(10,348,418)	(4,147,057)
Të ardhura të tjera		251,793,518	12,151,109
Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	23	251,793,518	12,151,109
Shpenzime financiare	24	(33,461,376)	(18,182,474)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(4,241,881)	1,394,610
Shpenzime të tjera financiare		(29,219,495)	(19,577,084)
Fitimi/humbja para tatimit		415,310,655	146,985,050
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(24,645,327)	(19,760,844)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	25	(24,645,327)	(19,760,844)
Fitimi/humbja e vitit		390,665,328	127,224,206
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		390,665,328	127,224,206

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Blessed Investment sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra Individuale e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

Pozicioni financiar më 1 janar 2021	Kapitali i nënshkruar 7,000,100	Fitimet e Pashpërndara 808,825,010	Fitim / Humbja e vitit 117,176,114	Totali 933,001,224
Transferim në fitime të mbartura	-	117,176,114	(117,176,114)	-
Fitim/Humbja e viti	-	-	127,224,206	127,224,206
Dividendë të paguar	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	7,000,100	926,001,124	127,224,206	1,060,225,430
Transferim në fitime të mbartura	-	127,224,206	(127,224,206)	-
Fitim/Humbja e viti	-	-	390,665,328	390,665,328
Dividend te paguar	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	7,000,100	1,053,225,330	390,665,328	1,450,890,758

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra Individuale e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		390,665,328	127,224,206
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
Amortizimi	10	10,348,418	4,147,057
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>			
Te ardhura nga dividendet		(251,793,518)	(12,151,109)
Te ardhura nga interesi		4,241,881	(1,394,610)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
Rënie/(rritje) në investime në process		185,658,550	510,370,180
Rënie/(rritje) në te arketueshme te tjera		(251,982,636)	(199,670,413)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(126,194,474)	(409,434,307)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(39,056,451)	19,091,004
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Para neto të përdorura për blerjen e njesive te kontrollura		138,436	(26,007,673)
Pagesa për blerjen/paradheni e aktiveve afatgjata materiale		-	39,563,834
Toka per zhvillim		(136,140,788)	(107,427,409)
Blerje aktivesh afatgjata		(9,020,325)	(32,111,028)
Levizje ne investimet ne huadhenie		(805,826,157)	109,704,384
Interesa të arkëtuara		(4,241,881)	1,394,610
Dividentë të arkëtuar		362,258,173	8,955,088
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(592,832,542)	(5,928,194)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Dividend te paguar			-
Hua të marra	17	571,150,000	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		571,150,000	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		(60,738,993)	13,162,810
Mjetet monetare në fillim të periudhës		83,631,824	70,469,014
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	22,892,831	83,631,824

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

Blessed Investment sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NIPT L71423028S, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Njesinë Bashkiake nr 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Ndërtesa 1, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është zhvillimi i pasurive të paluajtshme, kryerja e operacioneve ekonomike, juridike e financiare si dhe e cdo biznesi që lidhen drejtpërdrejt ose terthorazi me realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, brenda kuadrit të dispozitave ligjore dhe kryerja e cdo aktiviteti të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 7,000,100 Lek dhe zotërohet nga ortakët i vetëm Besnik Leskaj.

Në 31 dhjetor 2022 shoqëria ka 3 punonjës. (2021: 2 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale (më poshtë referuar si 'pasqyrat financiare') janë përgatitur në përputhje me politikën kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), përveç mungesës së konsolidimit të Investimeve në Shoqëritë të Kontrolluara të listuara në shënimin. Me poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabel të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumën e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste Drejtimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Drejtimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
Euro/LEK	114.23	120.76
USD/ LEK	107.05	106.54

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet nëpasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Blessed Investment Sh.p.k njeh të gjitha investimet e tij në sipërmarrjet e përbashkëta sipas modelit të koston në pasqyrat financiare individuale të investitorit. Njohja e investimeve bëhet me kosto pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 5 Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale.

Shpërndarjet e marra nga investimi do të njihen si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitim të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe Drejtimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Mjete monetare në bankë	22,892,831	83,288,214
Në lekë	2,496,173	16,598,182
Në monedhë të huaj	20,396,658	66,690,032
Mjete monetare në arkë	-	343,610
	<u>22,892,831</u>	<u>83,288,214</u>

Blessed Investment sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(Vlerat janë në Lek)

5. Huadhënie ndaj palëve të lidhura

Huadhëniet ndaj palëve të lidhura afatgjatë dhe afatshkurtër më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<i>Huadhënie afatshkurtër</i>	969,613,390	162,376,748
Hua SPV 1	809,990,276	3,834,669
Hua SPV 2	2,739,088	2,347,938
Hua Afatshkurtër - Albanian Financial Institution	41,972,589	44,371,966
HUA GBI shpk	32,606,210	28,434,738
Hua Afatshkurtër - ARC	42,265,100	44,681,200
Hua Afatshkurtër - Abkons Serbia	15,992,200	16,906,400
Hua Afatshkurtër - Ikons Global Malta	2,344,228	2,478,237
Hua Ikons DOO	2,284,600	1,207,600
Hua Dobrota Tours Kotor Doo	-	18,114,000
Hua ASDC	17,134,500	-
Hua Rpay	2,284,600	-
<i>Huadhënie afatgjatë</i>	24,673,680	26,084,160
Hua Afatgjatë - Ikons Shqipëria	24,673,680	26,084,160
	994,287,070	188,460,908

6. Aktive të prodhuara për shitje

Aktivët e prodhuara për shitje më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Situacione ndërtimi nga investitorë	123,269,300	165,222,449
Kosto e tokës për ndërtim	-	121,573,308
Taksa e bashkisë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë	130,095,362	152,227,455
	253,364,662	439,023,212

7. Te arkëtueshme ndaj palëve të lidhura

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime për ndërtimin (shënim 26)	270,178,320	131,780,638
	270,178,320	131,780,638

8. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Dividentë të arkëtueshëm	140,675,878	30,211,223
Kliente të tjere	17,676,636	44,678,013
TVSH e arkëtueshme	398,369	596,732
Llogari të tjera të arkëtueshme	139,569	147,547
Shpenzime të periudhave të ardhshme	7,162,304	-
Parapagime për toka	3,426,898	90,525,845
Parapagime të tjera	200,002	400,000
	169,679,656	166,559,360

9. Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje

Investime në shoqëri të kontrolluara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aksione Abkons	116,164,222	116,164,222
Aksione Ikons shpk	900	900
Aksione Abkons Serbia	1,142,300	1,207,600
Aksione Ikons Serbia	1,142,300	1,207,600
Aksione Blessed Investment LTD	137,076	654,912
Aksione GBI	50,000	50,000
Aksione ASDC	50,000	50,000
Aksione SPV Blue 1	510,000	510,000
Aksione SPV Blue 2	510,000	-
Aksione RPAY	25,000,000	25,000,000
	144,706,798	144,845,234

9. Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje - vazhdim

Të dhënat mbi Investime në shoqërite e kontrolluara dhe pjesëmarrje detajohen më poshtë:

Emri	Adresa	Aktiviteti Kryesor	% e pjesëmarrjes
Aksione Abkons	Rruga "Themistokli Gërmenji, Ndërtesa Nr.6, Tiranë, Shqipëri	Sherbime konsulence inxhinierike	70%
Aksione Ikons shpk	Rruga "Dervish Hima", Ada Tour Nr1, Tiranë, Shqipëri	Sherbime dhe konsulencë ne fushën e IT/ zhvillim sowftware	75%
Aksione Abkons Serbia	Bulevar Kralja, Aleksandra 18, sprat 2, Beograd, Serbi	Sherbime konsulence inxhinierike	100%
Aksione Ikons Serbia	Bulevar Kralja, Aleksandra 18, Beograd-Vracar, Serbi	Sherbime dhe konsulencë ne fushën e IT/ zhvillim sowftware	100%
Aksione Blessed Investment LTD	35, STRAIT Street, Valletta VLT,1434, Malta	Investime ne sektorin e ICT	100%
Aksione GBI	Autostrada Tiranë-Durres, Tiranë, Shqipëri	Nr 7, Trajnime për sigurinë teknike dhe rrugore	50%
Aksione ASDC	Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr 18/2, Tiranë, Shqipëri	Investim në pasuri të paluajtshme	50%
Aksione SPV Blue 1	Rruga "Themistokli Gërmenji, Ndërtesa Nr.1, Tiranë, Shqipëri	Prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike fotovoltaike	51%
Aksione SPV Blue 2	Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr 18/2, Tiranë, Shqipëri	Prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike fotovoltaike	51%

Blessed Investment sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2022
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021:

Kosto	Ndërtesa	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Investime zyre	Instalime teknike	Totali
Gjendja më 1 janar 2021	166,947,728	-	-	-	-	166,947,728
Shtesa	32,111,028	-	-	-	-	32,111,028
Gjendja më 31 dhjetor 2021	199,058,756					199,058,756
Shtesa	-	843,028	1,077,691	6,048,835	1,050,772	9,020,325
Gjendja më 31 dhjetor 2022	199,058,756	843,028	1,077,691	6,048,835	1,050,772	208,079,081
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2021	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	4,147,057	-	-	-	-	4,147,057
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,147,057					4,147,057
Amortizimi i vitit	9,745,585	104,162	162,650	178,405	157,616	10,348,418
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	13,892,642	104,162	162,650	178,405	157,616	14,495,475
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2021	194,911,699	-	-	-	-	194,911,699
Gjendja më 31 dhjetor 2022	185,166,114	738,865	915,041	5,870,430	893,156	193,583,605

Nuk ka asnjë aktiv të qendrueshem të trupezuar të vendosur si kolateral deri më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

Blessed Investment sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive te mbajtura per investim

Aktive te mbajtura per investim konistojne ne toka per zhvillim dhe analizohen si më poshtë.

	Toka, troje dhe terrene
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2021	160,842,583
Shtesa	205,021,208
Pakësime	(97,593,799)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	268,269,992
Shtesa	136,140,788
Gjendja më 31 dhjetor 2022	404,410,780

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe më 31dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Furnitorë	4,281,136	139,784
	4,281,136	139,784

13. Të pagueshme ndaj paleve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31dhjetor 2022 dhe më 31dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Hua ndaj paleve te lidhura (shënimi 26)	22,138,400	37,152,000
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura (shënimi 26)	302,201,360	300,326,915
	324,339,760	337,478,915

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	132,697	81,951
Tatimi mbi te ardhurat personale	81,751	77,990
Tatim fitimi për tu paguar	9,824,694	19,653,704
Tatim ne burim	89,099	-
	10,128,241	19,813,645

Blessed Investment sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(Vlerat janë në Lek)

15. Parapagime të marra

Parapagime të marra më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime Fiori Di Bosco	-	35,176,866
Parapagime Gjiri i Lalzit	-	161,457,450
Parapagime AksesTirana	89,123,049	-
Parapagime të marra për qira	1,432,000	1,432,000
	90,555,049	198,066,316

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Te tjera detyrime	1,685,072	1,685,072
Paga dhe shperblime	73,706	73,706
	1,758,778	1,758,778

17. Hua e marrë nga bankat

Huamarrja afatgjatë më 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Hua e marrë nga FiBank	571,150,000	-
	571,150,000	-

18. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 7,000,100 Lek dhe zotërohet nga ortaku i vetëm Besnik Leskaj. Kapitali më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2021
Numri i kuotave	1	1
Vlera nominale	7,000,100	7,000,100
	7,000,100	7,000,100

19. Të ardhurat

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	551,525,496	992,886,618
Të ardhura të tjera	18,933,044	6,444,000
	570,458,540	999,330,618

20. Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndën e pare dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	336,550,063	834,467,816
	336,550,063	834,467,816

21. Të tjera shpenzime

Shpenzime të tjera detajohen si mëposhtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime konsulence	6,239,284	373,113
Shpenzime qeraje	4,918,695	102,815
Shërbime të tjera	173,126	98,256
Shpenzime telekomunikacioni	313,957	-
Udhetime dhe dieta	-	106,006
Konsulenca me zhvillim	-	1,029,931
Komisione bankare	148,305	236,961
Taksa të ndryshme	677,748	368,019
Shpenzime të tjera	5,491,482	1,890,468
Gjoha të ndryshme	22,655	6,527
	17,985,252	4,212,096

22. Shpenzime të personelit

Shpenzime te personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime për paga	7,709,333	3,047,549
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	886,961	439,685
	8,596,294	3,487,234

Numri i punonjësve më 31dhjetor 2022 është 3 punonjës (31 dhjetor 2021:2 punonjës)

23. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Tëardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse detajohen si mëposhtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga dividendët në shoqëritë ku është aksioner	251,793,518	12,151,109
	251,793,518	12,151,109

24. Shpenzime financiare (neto)

Shpenzimet financiare(neto) detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura/(shpenzimet) nga interesat	(4,241,881)	1,394,610
Të ardhura/(humbje)nga këmbimet valutore	(29,219,495)	(19,577,084)
	(33,461,376)	(18,182,474)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
A Fitimi para tatimit	415,310,655	146,985,050
Total shpenzime të panjohura	785,041	6,527
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	22,655	6,527
Shpenzime të panjohura	762,386	
Te ardhurat e patatueshme:		
Te ardhura nga dividendët	(251,793,518)	(12,151,109)
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzime te panjohura)	164,302,178	134,840,468
Humbje fiskale të mbartura	-	(3,101,505)
Fitimi paraTatimit	164,302178	131,738,963
Norma tatimore	15%	15%
B Tatim fitimi	24,645,327	19,760,844
A - B Fitimi i vitit	390,665,328	127,224,206

26. Transaksionet me palët e lidhura

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, si dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Matrix Konstruksion detyrime tregtare		894,852,913		742,149,569
Matrix Konstruksion detyrime te tjera	1,291,183,863	256,379,461	1,001,708,014	252,187,461
Divident për t'u shpërndarë				
Abkons	51,336,942		25,836,300	
Ikons	4,374,882		4,374,923	
Hua				
Hua nga ortakut		9,138,400		24,152,000
Hua Afatshkurtër- Ikons Global Malta	2,344,228		2,478,237	
Hua Afatshkurtër – GBI shpk	32,606,210		28,434,738	
Hua Afatshkurtër- Abkons Serbia	15,992,200		16,906,400	
Hua Afatshkurtër- Albanian Financial Institution	41,972,588		44,371,966	
Hua Afatgjatë- Ikons Shqipëria	24,673,680		26,084,160	
Hua-ARC	42,265,100	13,000,000	44,681,200	13,000,000
Hua-SPV Blue 1	809,990,276		3,834,669	
Hua-SPV Blue 2	2,739,088		2,347,938	
Hua Dobrota Tours Kotor Doo	-		18,114,000	
Hua ASDC	17,134,500		-	
Hua Rpay	2,284,600			
Hua Ikons DOO	2,284,600		1,207,600	
	2,341,182,757	1,173,370,774	1,220,380,145	1,031,489,030
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
		33,940		
Abkons				
Albanian Financial Institution	2,545,725		1,394,610	
Matrix Konstruksion		152,813,669		76,442,855
	2,545,725	152,847,009	1,394,610	46,442,855

27. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2022 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

28. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.